

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABELJ"
GJIROKASTËR
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE
NJËSIA BAZË E HISTORISË DHE GJEOGRAFISË


DEKANI

(Prof. Dr. Gëzim SALA)



REKTORI

(Prof. Dr. Bekdash MEMA)



PËRGJEGJËS I NJËSISË BAZË TË HISTORISË DHE GJEOGRAFISË

Prof. asoc. Albina SINANI



PLAN MËSIMOR

I PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË ARKEOLOGJI DHE ADMINISTRIMI I PASURIVE
ARKEOLOGJIKE

Forma e studimit: me kohë të plotë

Viti akademik: 2020 - 2021

Emërtimi i diplomës: MASTER I SHKENCAVE NË ARKEOLOGJI DHE ADMINISTRIMI I PASURIVE ARKEOLOGJIKE





VITI I PARË


Format e veprimtarive mësimore	Semestri I Javët	Semestri II Javët	Nr. vlerësimeve përfundimtare sipas semestrave	
			Semestri I	Semestri II
Mësim	15	15	-	-
Provime	3	3	4	4
Praktikë në terren	-	-	-	-
Tezë diplome	-	-	-	-
Gjithsej	18	18	4	4

VITI I DYTË

Format e veprimtarive mësimore	Semestri I Javët	Semestri II Javët	Nr. vlerësimeve përfundimtare sipas semestrave	
			Semestri I	Semestri II
Mësim	15	-	-	-
Provime	4	-	6	-
Praktikë në terren	-	6	-	1
Tezë diplome	-	9	-	1
Gjithsej	19	15	6	2




Nr.	LËNDËT VITI I (i parë)	Ngarkesa e lëndëve / veprimtariveformuese				Ngarkesa mësimore sipas semestrave kur zhvillohet lënda							ECTS
		Kategoria / Tipi i Komponentit mësimor	Gjithsej orë	Orë në auditor	Orë të studimit individual	Semestri I (i parë)			Semestri II (i dytë)			Provime	
1.	Teoria e studimit arkeologjik dhe studime bashkëkohore në arkeologji	A	200	90	110	6	4	2	-	-	-	P	8
2.	Histori e mendimit arkeologjik	B	200	90	110	6	4	2	-	-	-	P	8
3.	Metoda të thelluara të studimit arkeologjik	B	200	90	110	-	-	-	6	4	2	P	8
4.	Arkeologjia e shfaqjeve protourbane & urbane	B	200	90	110	-	-	-	6	4	2	P	8
5.	Letërsi Greko-Romake	B	175	75	100	5	3	2	-	-	-	P	7
6.	Arkeologji e antikitetit të vonë dhe mesjetës	B	175	75	100	5	3	2	-	-	-	P	7
7.	Prehistoria e Shqipërisë	B	175	75	100	-	-	-	5	3	2	P	7
8.	Etnoarkeologjia	B	175	75	100	-	-	-	5	3	2	P	7
Gjithsej Viti I (i parë)			1500	660	840	22	14	8	22	14	8	8	60



Ngarkesa e lëndëve / veprimtariveformuese															Ngarkesa mësimore sipas semestrave kur zhvillohet lënda						
Nr.	LËNDËT VITI II (i dytë)	Kategoria / Tipi i Komponentit mësimor	Gjithsej orë	Orë në auditor	Orë të studimit individual	Praktikë në terren	Semestri I (i parë)			Semestri II (i dytë)				Provime	ECTS						
							Orë në javë	Leksione	Seminare	Orë në javë	Leksione	Seminare	Praktikë në terren								
1.	Prehistoria e Ballkanit	B	150	60	90	-	4	3	1	-	-	-	-	P	6						
2.	Civilizimi Bizantin	B	150	60	90	-	4	3	1	-	-	-	-	P	6						
3.	Parime të administrimit të pasurive arkeologjike	C	150	60	90	-	4	3	1	-	-	-	-	P	6						
4.	Gjeopopullimi në lashtësi	C	75	30	45	-	2	1	1	-	-	-	-	P	3						
5.	Gjeografia e qytetërimeve të lashta	C	75	30	45	-	2	1	1	-	-	-	-	P	3						
6.	Lëndë me zgjedhje ¹ -Arkeologia e provincave Romake -Numizmatika -Mitologia	C	150	60	90	-	4	3	1	-	-	-	-	P	6						
7.	Praktikë në terren	D	300	-	150	150	-	-	-	-	-	-	300 ²	P	12						
8.	Tezë diplome	E	450	-	450 ³	-	-	-	-	-	-	-	-	P	18						
Gjithsej Viti II (i dytë)			1500	300	1050	150	20	15	5	-	-	-	300	7	60						
Gjithsej Viti I (i parë) dhe Viti II (i dytë)			3000	960	1890	150	-	-	-	-	-	-	300	16	120						

¹Në semestrin e I (e parë), Viti II (i dytë), studenti duhet të zgjedhë 1 (një) lëndë nga lëndët me zgjedhje dhe të fitojë 6 ECTS.
²12 kredite praktikë në terren janë 300 orë gjithsej, nga të cilat 150 orë janë orë të praktikës në terren, në ndihmë të procesit mësimor, të realizuar në bashkëpunim me institucionet e shtetit dhe të sektorit privat.
³Javë mësimore ose 30 ditë, në semestrin e II (e dytë), pasi 1 (një) ditë punë në praktikë është 5 orë mësimore dhe 150 orë janë të studimit individual të përbërë nga 450 orë në kolonën Orë të studimit individual janë orë të planifikuara për përgatitjen individuale të studentit për tezen e diplomës, për 9 (nëntë) javë mësimore.



PROGRAMI I LËNDËS
Gjeopopullimi në lashtësi

Titullari /pedagogu i lëndës: Valbona Duri, "Profesor i asociuar", "Doktor"

Ngarkesa: Numri i krediteve 3, numri i orëve mësimore në klasë 30, leksione 15, seminarë 15

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti akademik 2021-2022 / Semestri III (i tretë)

Lloji i lëndës: E detyrueshme

Programi i studimit: Programi i Ciklit të Dytë të studimeve "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike"

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: vduri@uogj.edu.al

Kodi i Etikës: Pedagogu dhe studenti duhet të respektojnë rigorozisht tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse, të parashikuara në rregulloren e UGJ-së dhe të programit të studimit

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Kjo disipline ka si qëllim të njohë studentin nëpërmjet gjetjeve arkeologjike (si të vetme burime dëshmuarë periudhën prehistorike) gjurmët e hershme të popullimit sipas epokave të hershme historike të zhvillimit të shoqërisë njerëzore: paleolitit, mezolitit, neolitit, eneolitit, bronzi dhe hekuri deri në antikitetin e vonë shek V p.e.s. Një trajtim i veçantë i kushtohet popullimit të territoreve që përfshiheshin në qytetërimet e lashta pranë lumenjëve Tigër –Eufrat (Irku i sotëm), Egjiptit (në deltën e Nilit) dhe përgjatë luginës së lumit Indus. Gjatë kësaj disipline nuk mungon trajtimi i dukurisë së popullimit në territorin e Ilirisë gjatë antikitetit të mesëm dhe të vonë.

Pas përfundimit të lëndës studentët do të jetë në gjendje të:

1. Të aftë të njohin dhe vlerësojnë evolucionin popullativ (demografik) në termat kohor dhe territorial në tërësinë e zhvillimeve të kohës
2. Të aftë të vlerësojnë dhe analizojnë ndryshimet popullore nën kontekstin e lindjes dhe zhvillimit të civilizimeve të hershme.
3. Të njohin historikun e popullimit të hershëm.
4. Të aftë të njohin shtrirjen gjeografike të civilizimeve të hershme dhe popullsisë së tyre.

KONCEPTET THEMELORE:

1. Epokë prehistorike
2. Antikiteti I hershëm, I mesëm dhe I vonë.
3. Civilizime të hershme.
4. Gjeopopullim.
5. Kolonizim.



TEMAT E LËNDËS

Tema I.

Parahistoria njerëzore: Epoka e paleolitit(1.5 milion-10 000), epoka më e hershme dhe më e gjatë e shoqërisë njerëzore.

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim)

Tema II.

Parahistoria njerëzore: Epoka e Mezolitit(10 000-6000).Popullimi gjatë kësaj epoke nëpërmjet deshmive arkeologjike.

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim)

Tema III

Parahistoria njerëzore: Epoka e Neolitit (gurit të zi 6000-3000).Gjeopopullimi gjatë Neolitit.

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim)

Tema IV

Parahistoria njerëzore: Epoka e Eneolitit(3000-2100). Gjeopopullimi gjatë kësaj epoke.

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim).

Tema V

Popullimi në qytetërimet e hershme(Mesopotami, Egjip dhe luginën e lumit Indus).

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim).

Tema VI

Parahistoria njerëzore: Epoka e Bronzit(2100-1100). Gjeopopullimi gjatë kësaj epoke.

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim).

Tema VII

Parahistoria njerëzore: Epoka e Hekurit(1100—500). Gjeopopullimi gjatë kësaj epoke.

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim).

Tema VIII

Antikiteti klasik.Popullimi në Greqinë e lashtë. Shtrirja e popullsisë dhe vendbanimeve.

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim).

Tema IX

Gjeopopullimi në Perandorinë Romake.

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim).

Tema X

Gjeopopullimi në Antikitetin e vonë(Perandoria Bizantine).

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim)

Tema XI

Popullimi në Ilirinë e Jugut në shek VII-V p. e.s.

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim).

Tema XII

Popullimi dhe vendbanimet(forufikimet) në Ilirin në shek V –I p. e.s.

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim).

Tema XIII

Popullimi dhe vendbanimet në Iliri në shek I-III pas. e.s.

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim).

Tema XIV

Popullimi dhe vendbanimet në Iliri antikitetin e vonë(shek IV-VI).

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim).

Tema XV

Popullimi dhe vendbanimet në Iliri antikitetin e vonë shek IV-VI(vazhdim).

Teksti bazë: Leksion(dorëshkrim).

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE



FREKUENTIMI: Frekuentimi i detyruar deri në masën 80 % të seancave të seminareve.
KONTROLLI I VAZHUESHËM:

Vlerësim i vazhduar dhe provim final me shkrim në përfundim të lëndës

Provimi final 80%

Vlerësim i vazhduar 20%

Vlerësimi i vazhduar do të jetë shumatore e vlerësimit të pedagogut mbi kryerjen e detyrave si më poshtë:

- rezultatet e testeve 10 %
- aktivizimin në seancat e seminareve 10 %

Studenti rezulton kalues me minimalisht 45% të vlerësimit total apo 45 pikë.

PROVA FINALE: Provim me shkrim në fund të semestrit

LITERATURA

a) Literatura bazë e detyrueshme: Leksione(dorëshkrime)

b) Literatura e rekomanduar:

1. Ceka N. Korkuti M. Arkeologjia Greqia-Roma-Iliria. Tiranë 1993.
- 2.

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS :

Studentët janë të detyruar të veprojnë në përputhje me dhe të respektojnë në mënyrë rigoroze tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së për t'u sjellë me integritet akademik mbështetur në ndershmërinë.

Studentët janë të detyruar :

- Të mos kopjojnë apo japin kopje në provim
- Të mos kopjojnë dhe paraqesin punën e dikujt tjetër
- Të mos fabrikojnë apo manipulojnë të dhënat
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njerëzor & profesional të personelit akademik dhe atij ndihmës
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njerëzor & profesional të studentëve të tjerë

Në raste shkeljesh të këtyre rregullave studentet penalizohen sic parashikon rregullorja e UGJ-së dhe rregullorja e programit të studimit.



PROGRAMI I LËNDËS

Gjeografia e qytetërimeve të lashta

Titullari / pedagogu i lëndës: Albina Sinani, "Profesor i asociuar", "Doktor"

Ngarkesa: Numri i krediteve 3, numri i orëve mësimore në klasë 30, leksione 15, seminare 15

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti akademik 2021-2022 / Semestri III (i tretë)

Lloji i lëndës: E detyrueshme

Programi i studimit: Programi i Ciklit të Dytë të studimeve "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike"

Adresa elektronike e titullarit / e pedagogut të lëndës: a_sinani@uogj.edu.al

Kodi i Etikës: Pedagogu dhe studenti duhet të respektojnë rigorozisht tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse, të parashikuara në rregulloren e UGJ-së dhe të programit të studimit

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Lënda *Gjeografia e qytetërimeve të lashta* është thelbësore në zhvillimin shkencor të studentëve të këtij programi studimi, të cilët do t'i kuptojnë çështjet e temave, nëpërmjet analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga ndërvarësitë kulturore dhe përvojat e së shkuarës. Studimi i lëndës i ndihmon studentët të zhvillojnë personalitetin shkencor, të respektojnë vërtetësinë e burimeve historike dhe gjeografike. Lënda përfshin një material gjeografik, kulturor, historik të qytetërimeve të lashta, që kanë jetuar në viset e Babilonisë, Mesopotamisë, Shamit etj: haldeasve, asirianëve, medëve, fenikasve, hititëve, egjiptasve, persëve, hebrenjve, babilonasve etj. Lënda kryesisht, synon të merret me shpjegimin e mënyrës sesi të gjitha këto aspekte kulturore janë zhvilluar dhe kanë ndryshuar gjatë historisë së tyre, në rajone të ndryshme gjeografike. Në këtë mënyrë, studentët do të kuptojnë rëndësinë që ka ndryshimi për të gjitha përvojat njerëzore, për kompleksitetin dhe mënyrat e ndryshme në të cilat bashkëveprojnë të gjitha këto përvoja socio-gjeografike.

Detyra e programit të kësaj lënde është të drejtojë studentët, të trajtojnë gjeografikisht në mënyrë kritike fenomenet e epokave të së shkuarës, të kuptojnë vatrat e hershme kulturore, si rezultat i një procesi të gjatë integrues ndërkulturor dhe evolutiv.

Këto cilësi mbështesin studentët në zhvillimin e qëllimeve, kompetencave kyçe dhe rezultateve të dëshiruara, në mënyrë që të jenë të aftë për t'iu përgjigjur zhvillimeve globale, nëpërmjet:

- pajisjes me kompetencat e duhura, për të kontribuar në mënyrë aktive dhe me përgjegjësi në ndërtimin e perspektivës;
- argumentimit të vlerave të trashëgimisë kulturore, si pjesë e përcaktimit të identitetit kombëtar;
- vlerësimit të pozitës gjeografike të qytetërimeve botërore;
- zhvillimit të aftësive të kërkimit shkencor, duke u bazuar në burimet historike dhe gjeografike;
- krijimit të mundësive për të ndërtuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, për zhvillimin gjeografik të qytetërimeve antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në vend, rajon dhe botë;
- njohurive për disa disiplina shkencore të këtyre popujve: matematikën, astronominë, mjekësinë, bujqësinë, peshkimin, detarinë, jetën ekonomike etj.

Duke bërë kërkime mbi historinë dhe gjeografinë e qytetërimeve në antikitet, në mesjetë, në periudhën moderne dhe bashkëkohore, studentit i krijohet mundësia të përdorë këto burime për të kuptuar lidhjet e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, periudhave, shoqërive etj.



Gjithashtu, studenti analizon marrëdhëniet shkak-pasojë si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, duke krijuar bindjen shkencore se qytetërimet e sotme janë vazhdimësi progresive e qytetërimeve të hershme, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur ngushtësisht me të.

Pas përfundimit të këtij programi studenti do të jetë në gjendje të njohë arritjet kulturore të popujve të lashtë, të fitojë shkathtësi hulumtuese shkencore, të interpretojë dhe analizojë faktet historike në kontekste të ndryshme shoqërore, gjeografike, ekonomike etj.

Në ligjëratat mbi temat e kësaj lënde do të përdoren metoda interaktive dhe strategji të mësimdhënies. Studentët do të inkurajohen që t'i zhvillojnë shkathtësitë e mësimnxënies dhe të kompetencës në fushën e punës kërkimore-shkencore dhe të vlerësojnë besueshmërinë e burimeve të informacionit.

Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të:

1. njohë arritjet kulturore të popujve të lashtë, të fitojë shkathtësi hulumtuese shkencore, të interpretojë dhe analizojë faktet historike në kontekste të ndryshme shoqërore, gjeografike, ekonomike etj. Në ligjëratat mbi temat e kësaj lënde do të përdoren metoda interaktive dhe strategji të mësimdhënies;
2. zhvillojnë shkathtësitë e mësimnxënies dhe të kompetencës në fushën e punës kërkimore-shkencore dhe të vlerësojnë besueshmërinë e burimeve të informacionit;
3. vlerësojnë rolin e mjedisit në zhvillimin e qytetërimeve antike, kohën dhe rrethanat e lindjes së qytetërimit antik;
4. demostrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi kushtet ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore të qytetërimeve antike, duke evidentuar lidhjen midis tyre;
5. analizojnë qytetërimin bizantin dhe atë arab, shkaqet e lindjes, shtrirjen gjeografike, duke evidentuar ndikimin e këtyre qytetërimeve në Evropë dhe në Botë;
6. vlerësojnë, arsyetojnë dhe shpjegojnë rolin dhe rëndësinë e Bashkimit Evropian në prirjet dhe perspektivën e qytetërimeve të sotme bashkëkohore.

KONCEPTET THEMELORE:

1. qytetërimet antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore
2. ndërvarësi kulturore
3. trashëgimi materiale dhe shpirtërore
4. informacion historik dhe gjeografik
5. identitet kombëtar
6. zhvillim i qëndrueshëm
7. dimensione lokale, kombëtare, rajonale, evropiane e globale
8. shkëmbime të shumanshme
9. shumëllojshmëri kulturore, etnike, rajonale, gjuhësore, sociale, ekonomike, teknologjike, politike dhe fetare
10. kronologji kohore dhe hapësinore
11. pakica kombëtare
12. shoqëri evropiane dhe joevropiane
13. ndërvarësi ndërmjet qytetërimeve
14. globalizëm
15. integrim evropian
16. zbulimet e mëdha gjeografike
17. trashëgimi osmane
18. emancipim
19. perandori shumëkombëshe



- 20. koloni greke
- 21. kultura helenistike
- 22. edukim spartan
- 23. dyndjet sllave

TEMAT E LËNDËS:

Tema I – Lashtësia.

Analizon dhe njihet studentët me konceptet lashtësi dhe qytetërim, me kushtet gjeografike dhe premiset e lindjes së qytetërimeve të lashta.

Çështjet:

- Fillimet e shoqërisë njerëzore.
- Epoka e Neolitit.
- Premiset për lindjen e qytetërimeve të lashta.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

Tema II – Shtrirja gjeografike e qytetërimeve të para.

Synon njohjen me qytetërimet e para, aktivitetet dhe sukseset e tyre. Studentët demonstronë qëndrime dhe vlera mbi shkencat e lashta si: matematika, astronomia, mjekësia, bujqësia, gjuetia, dhe peshkimi.

Çështjet:

- Qytetërimet e Mesopotamisë.
- Qytetërimi egjiptian i lashtësisë.
- Qytetërimi hitit.
- Qytetërimi fenikas.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

Tema III – Shtrirja gjeografike e qytetërimeve të para.

Vlerëson trashëgiminë kulturore të qëndrueshme dhe të pavdekshme të qytetërimeve të para, artin dhe arkitekturën, të cilat u shpërndanë më pas, në tërë cepat e botës.

Çështjet:

- Qytetërimi hebraik i antikitetit.
- Qytetërimi persian.
- Qytetërimi i vjetër indian.
- Qytetërimi kinez i lashtësisë.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

Tema IV – Qytetërimi antik grek dhe romak.

Përmes kësaj tematike, studentët demonstronë qëndrime e vlera mbi kushtet, etapat dhe tiparet ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore të qytetërimeve antike në Greqi dhe Romë.

Çështjet:

- Qytetërimi antik Grek.
- Qytetërimi antik Romak.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

Tema V – Qytetërimi antik grek dhe romak.

Kjo tematikë pajis studentin me njohuri, shprehje dhe qëndrime, për të analizuar e krahasuar zhvillimet e qytetërimeve antike në Greqi dhe Romë, duke evidentuar lidhjen midis këtyre qytetërimeve.

Çështjet:

- Besimi në Greqinë dhe Romën antike.
- Rënia e qytetërimeve antike në Evropë.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).



Tema VI – Qytetërimet botërore në mesjetë.

Përmes kësaj tematike studentët do të fitojnë njohuri, qëndrime dhe vlera mbi etapat kryesore nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i shoqërisë mesjetare dhe qytetërimet në mesjetë.

Çështjet:

- Qytetërimi bizantin.
- Tiparet e qytetërimit arab.
- Perandoria e shenjtë Romake.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

Tema VII – Qytetërimet botërore në mesjetë.

Evidenton, vlerëson dhe shpjegon kalimin nga qytetërimet antike në qytetërimet mesjetare, kupton lidhjen ndërmjet tyre, tregon ndryshimet, që pësuan këto qytetërimet në mesjetë, analizon veçoritë e organizimit ekonomik, politik dhe kulturor të këtyre qytetërimeve.

Çështjet:

- Monarkia Angleze.
- Monarkia Franceze.
- Marrëdhëniet midis qytetërimit arab dhe qytetërimeve evropiane.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

Tema VIII – Qytetërimet në fillimet e historisë moderne.

Synon njohjen me kthesën e madhe, që morën qytetërimet botërore pas Rilindjes Evropiane dhe zbulimeve të mëdha gjeografike.

Çështjet:

- Italia, qendër e Rilindjes dhe kulturës Evropiane.
- Zbulimet e mëdha gjeografike.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

Tema IX – Qytetërimet në fillimet e historisë moderne.

Vlerëson ndryshimet rrënjësore në jetën ekonomike, politike, shoqërore, humane, kulturore, shkencore dhe fetare, të cilat sollën fillimin e botës moderne dhe patën ndikim në arritjet e qytetërimit bashkëkohor.

Çështjet:

- Ndryshimet fetare në Evropë.
- Perandoria Osmane dhe Ballkani.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

Tema X – Koha e ndryshimeve thelbësore.

Analizon ndryshimet rrënjësore, që shkaktuan revolucionet politike, industriale dhe ideologjike në qytetërimin botëror.

Çështjet:

- Franca (*Absolutizmi në Francë dhe Revolucioni Francez*).
- Rusia.
- Spanja dhe Portugalia.
- Revolucioni anglez.
- Revolucioni amerikan.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

Tema XI – Koha e ndryshimeve thelbësore.

Kjo temë i njeh studentët me lindjen e nacionalizmit, i cili çoi në krijimin e shteteve nacionale në Evropën Qendrore dhe Ballkan. Gjithashtu, linja trajton edhe fillimet e liberalizmit në jetën politike dhe ekonomike, për sigurimin e të drejtave sociale dhe politike.

Çështjet:

- Revolucioni i Parë dhe i Dytë Industrial.
- Perandoria osmane, model i shpërbërjes së perandorive shumëkombëshe.



- Bashkimi i Italisë.
- Gjermania.
- Anglia drejt demokracisë liberale.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

Tema XII – Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945).

Përmes kësaj tematike studentët demostrojnë njohuri, aftësi, qëndrime dhe vlera mbi krizat që çuan në fillimin e luftërave botërore, mbi shkaqet dhe pasojat e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Studentët vlerësojnë trashëgiminë e luftërave botërore në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të qytetërimit botëror.

Çështjet:

- Fillimet e krizave të shek. XX-të. Lufta dhe paqja (1914-1920).
- Bashkimi Sovjetik (BRSS).
- Fashizmi në Itali.
- Gjermania.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

Tema XIII – Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945).

Kjo tematikë i mëson studentëve përpjekjet e bëra për kapërcimin e krizave ekonomike, si dhe krijon bindjen se çdo konflikt rajonal apo me shtrirje të gjerë sjell kosto negative për të ardhmen e shoqërisë.

Çështjet:

- SHBA, modeli i një shteti liberal.
- Franca.
- Turqia, krijimi i një shteti laik kombëtar.
- Lufta e Dytë Botërore (1939-1945).

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

Tema XIV – Qytetërimet bashkëkohore (1945-sot).

Përmes kësaj tematike studentët fitojnë njohuri, aftësi, qëndrime dhe vlera mbi zhvillimet gjeopolitike, ekonomike dhe shoqërore të dy blloqeve të krijuara pas Luftës së Dytë Botërore, bllokut perëndimor dhe bllokut lindor. Nëpërmjet këtyre modeleve të marra në studim, ata analizojnë dhe krahasojnë tiparet politike, ekonomike dhe shoqërore të këtyre dy blloqeve.

Çështjet:

- Bota menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore (1945-1946).
- BRSS gjatë viteve 1945-1990.
- SHBA gjatë viteve 1945-2000.
- Procesi i dekolonizimit.
- Italia gjatë viteve 1945-2000.
- Franca gjatë viteve 1945-2000.
- Britania e Madhe gjatë viteve 1945-2000.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

Tema XV – Qytetërimet bashkëkohore (1945-sot).

Vlerëson rolin dhe rëndësinë e Bashkimit Evropian, shpjegon prirjet e qytetërimeve sot, si ndryshime në strukturën sociale, globalizimin, uniformitetin, zhvillimin e shkencës, teknologjisë, kulturës, artit, arsimit, për prirjen dhe perspektivën e qytetërimeve të sotme.

Çështjet:

- Gjermania gjatë viteve 1945-1991.
- Jugosllavia gjatë viteve 1945-1990.
- Blloku lindor gjatë viteve 1945-1989.
- Evropa Qendrore dhe Lindore.



- Shpërbërja e BRSS dhe e Jugosllavisë.
- Bashkimi Evropian.
- Prirjet e qytetërimeve sot.

Teksti bazë: Ligjëratë e përgatitur (në dorëshkrim).

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI: Frekuentimi i detyruar deri në masën 80% të seancave të seminareve.

KONTROLLI I VAZHUESHËM:

Vlerësim i vazhduar dhe provim final me shkrim në përfundim të lëndës:

Provim final, 80%

Vlerësimi i vazhduar, 20%

Vlerësimi i vazhduar do të jetë shumatore e vlerësimit të pedagogut, mbi kryerjen e detyrave si më poshtë vijon:

- rezultatet e testeve, 10%
- aktivizimin në seancat e seminareve, 10%

Studenti rezulton kalues me minimalisht 45% të vlerësimit total, apo 45 pikë.

PROVA FINALE: Provim me shkrim, në fund të semestrit.

LITERATURA

a) Literatura bazë e detyrueshme:

1. Ligjëratat të përgatitura enkas për student (*hard copy dhe dorëshkrim*).

b) Literatura e rekomanduar:

1. Bergsten, K. E. 1988: Geography: my inheritance. In Hägerstrand, T. and Buttimer, A. editors, Geographers of Norden. Reflections on Career Experiences, *Lund Studies in Geography, Ser. B., Human Geography*, 52, Lund: Lund University Press, pp. 61–70. Witold Wilczyński.
2. Ceka N. Korkuti M. Arkeologjia Greqia-Roma-Iliria. Tiranë 1993.
3. Johnston, R. 2006: Geography (or geographers) and earth system science. *Geoforum*, vol 37, no. 1, pp. 7–11.
4. Klezie, R. Historia e gjeografisë.
5. Komba, E. Gjeografia teorike praktike me të dhëna historike. Majer, A. 6000 vjet kërkim dhe zbulime.
6. Pitman, A. J. 2005: On the role of Geography in Earth System Science. *Geoforum*, vol 36 no. 2, pp. 137–148.
7. Urban, I. Njohuritë dhe përrallat gjeografike në kohën greko-romake.
8. Wardenga, U. and Wilczyński, W. 1998: Introduction. In Wardenga, U. and Wilczyński, W. editors, *Religion, Ideology, and Geographical Thought*. IG U/IUHPS Commission on the History of Geographical Thought, Kielce: Jedność, pp. 7–11.
9. Wilczyński, W. 1996: *Idea przyrody w historii myśli geograficznej (Idea of Nature in the History of Geographical Thought)*. Kielce: Jedność.



VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Studentët janë të detyruar të veprojnë në përputhje me rregulloren e UGJ-së, dhe të respektojnë në mënyrë rigoroze tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse, të parashikuara në rregulloren e UGJ-së, për t'u sjellë me integritet akademik, mbështetur në ndershmërinë.

Studentët janë të detyruar të zbatojnë elementet e kodit të etikës:

- Të mos kopjojnë apo japin kopje në provim.
- Të mos kopjojnë në punën e dikujt tjetër.
- Të mos fabrikojnë apo manipulojnë të dhënat.
- Të respektojnë dinjitetin e integritetin njerëzor e profesional të personelit akademik e atij mbështetës.
- Të respektojnë dinjitetin e integritetin njerëzor e profesional të studentëve të tjerë.

Në rast shkeljesh të këtyre rregullave të kodit të etikës, studentët penalizohen siç parashikon rregullorja e UGJ-së dhe rregullorja e programit të studimit.

